Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË TREGTISË DHE INDUSTRISË PËR VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Rozeta Hajdari, Ministre

Adresa: Rr.”Muharrem Fejza”, p.n Lagjja e Spitalit, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Kontrata në vlerë 1,286,691€, dhe aneks kontrata në vlerë 128,223€, për Projektin " Ndërtimi i Infrastrukturës për Parkun Industrial në Lumadh" ishin përcjellë me mangësi të ndryshme duke filluar nga hartimi i projektit deri tek ekzekutimi i punimeve.

B1 Ishin bërë pagesa të parregullta në vlerë 122,738€, për të punësuarit me Marrëveshje të Brukselit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1 Pasuritë kapitale me vlerë mbi 1,000€, të prezantuar në nenin 19.1 në Raportin Vjetor Financiar ishin të mbivlerësuara. Kjo për faktin se 7,882,045€, pasuri që ishin në kuadër të programit 23300, nuk ishin bartur pas ristrukturimit tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Po ashtu, pasuria ishte e nënvlerësuar për 923,265€, sepse 12 pagesa të realizuara gjatë vitit 2020 nga kategoria e investimeve kapitale nuk ishin regjistruar në SIMFK në mungesë të zyrtares së pasurisë. Kjo ishte shpalosur në PFV-të e ministrisë.

Pasuritë jokapitale me vlerë nën 1,000€, të prezantuar në nenin 19.2 në Raporti Vjetor Financiar ishin të nënvlerësuar sepse 17 pagesat e realizuara për blerjen e pajisjeve të ndryshme nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në vlerë 10,065€ nuk ishin regjistruar në E-pasuri.

Pas këshillës tonë, vlera e aseteve 913,000€ ishte regjistruar në regjistër (datë 23.04.2021). Ndërsa, për largim të aseteve që janë në pronësi të MZHE-së, ishte dorëzuar kërkesa në MF mirëpo një gjë e tillë akoma nuk është implementuar.

2 Vlera e shpenzimeve 154,195€ ishte regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Pagesat e regjistruara si Mallra dhe Shërbime i përkisnin natyrës së Subvencioneve për mbajtjen e panaireve ndërkombëtare me qëllim të përkrahjes së ndërmarrjeve në Kosovë. Këto pagesa ishin realizuar nga MTI në kodin përkatës, mirëpo pas ristrukturimeve të kësaj ministrie këto shpenzime ishin bartur gabimisht nga Ministria e Financave tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Kjo vlerë ishte shpalosur në PVF.

Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak të këtyre çështjeve

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikun 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike[4]



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 5].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në projektin "Ndërtimi i Infrastrukturës për Parkun Industrial në Lumadh"

Gjetja

Neni 52 paragrafi 3 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh: "Për punë ose shërbime shtesë që nuk janë përfshirë në kontratën origjinale që u nënshtrohen disa kushteve të caktuara Operatori Ekonomik (OE) i njëjtë ekzekuton shërbimet ose punët shtesë, që nuk mund të ndahen në mënyrë teknike ose ekonomike, megjithëse si të ndara janë tejet të nevojshme për kompletim, si dhe vlera nuk është më shumë se 10 % e vlerës së kontratës origjinale)".

Bazuar në marrëveshjen e datës 16.07.2018 me Komunën e Vushtrrisë, MTI kishte lidhur kontratë (datë 25.03.2019) me një OE për projektin "Ndërtimi i Infrastrukturës për Parkun Industrial në Lumadh" në vlerë 1,286,691€. Gjatë rishikimit të pagesave të realizuara në vitin 2020 dhe ekzaminimit fizik për këtë projekt kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

Disa pozicione të përshkruara tek pjesa II e dosjes së tenderit (përshkrimi i çmimeve), nuk ishin hartuar në harmoni me projektin ekzekutiv dhe po ashtu disa pozicione tjera të parapara në projekt nuk ishin hartuar sipas gjendjes reale të terrenit. Pas fillimeve të punimeve dhe vlerësimit të kushteve të terrenit, nga Operatori Ekonomik (OE) ishte paraqitur nevoja për realizimin e dy pozicioneve shtesë (Furnizimi, transporti dhe punimi i materialit mbushës guror dhe rrafshimi i nën bazës me ngjeshje) të cilat nuk ishin paraparë në kontratën bazë. Zyra e Prokurimit dhe Sekretari kishin miratuar kërkesën e Menaxherit të Projektit dhe pas zhvillimit të procedurës së negociuar pa publikim, me datë 12.11.2019 ishte lidhur aneks kontrata me OE-në e njëjtë në vlerë 128,223€.

Nga rishikimi i pagesave të realizuara kemi vërejtur që sasitë e realizuara të aneks kontratës ishin në vlerë 240,756€, duke tejkaluar vlerën e sasive shtesë të parapara në ankesë kontratë për 112,533€.

Me tutje, lidhur me atë se a lejohen ndryshimet në kontratë gjatë ekzekutimit të kontratës, me datë 26.06.2020 KRPP në web faqe kishte dhënë interpretim se "Kurdo që ndryshimi i kontratës zgjeron në mënyrë të konsiderueshme objektin e kontratës me qëllim që të përfshihen më shumë sasi të furnizimeve, shërbimeve apo punëve shtesë, konsiderohet ndryshim thelbësor dhe rrjedhimisht nuk lejohet. Kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë e vetmja alternativë është që të ndërpritet kontrata aktuale dhe të iniciohet procedurë e re e prokurimit."

Gjatë ekzekutimit të këtij projekti kishte ndryshime të mëdha të pozicioneve. Disa pozicione ishin eliminuar dhe në disa raste sasitë e kontraktuara ishin rritur/zvogëluar në mes të pozicioneve të ndryshme me çmime të ndryshme. Po ashtu, ishin realizuar disa pozicione (punët e lëshesave pllakore dhe të kanalit të hapur) të cilat nuk ishin të përfshira as në kontratën bazë dhe as në aneks kontratë por vetëm në projekt ekzekutiv. Tejkalimi i sasive të aneks kontratës dhe ekzekutimi i pozicioneve tjera që

nuk ishin të përfshira në projekt ishin mbuluar nga tepricat e sasive në pozicione tjera të kontratës bazë. Pavarësisht nevojave për ndryshime thelbësore në kontratë, MTI nuk kishte ndërprerë kontratën ashtu siç parashihet.

Përveç kësaj, Ligji i Prokurimit Publik (neni 28 pika 2 dhe 10) precizon se "*Autoriteti Kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës së punëve të kërkuara"*

Në paramasë dhe parallogari ishte paraparë pozicioni "Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt", ku nuk ishte përshkruar saktë natyra dhe karakteristika e punëve të kërkuara ashtu siç kërkohet me rregullativën ligjore. OE i shpërblyer me kontratë për këtë pozicion kishte ofertuar vlerën 130,000€. Bazuar në të dhënat e prezantuara në ditarin ndërtimor, ky pozicion ishte realizuar për një ditë pune. Si rrjedhojë, gjatë ekzaminimit fizik ishte e pamundur të verifikohet çfarë realisht është ekzekutuar për këtë pozicion.

Hartimi i specifikave teknike në mënyrë jo të duhur nga njësia e kërkesës të cilat në shumicën e pozicioneve nuk ishin në harmoni me projektin ekzekutiv ishte shkak i paraqitjes së nevojës për ndryshime thelbësore të sasive të kontratës bazë. Ndërsa, aprovimi i këtyre ndryshimeve dhe aplikimi i procedurave jo adekuate për lidhje të aneks kontratës nga MTI ishte për shkak të kuptuarit jo të drejt të kërkesave ligjore nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të hapura në rastet kur sasitë shtesë tejkalojnë 10% të vlerës së kontratës mund të ndikoj në dëmtim të konkurrencës. Gjithashtu, ndryshimi i paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar vë në dukje dobësitë e kontratës dhe të kontrolleve të ushtruara nga menaxhmenti.

Rekomandimi A1 Ministrja duhet të sigurohet se specifikat teknike janë hartuar në harmoni me projektet ekzekutive dhe aprovimet e ndryshimeve duhet të behën vetëm për rastet e lejuara me ligj. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja për punë shtesë të bëhet një analizë e hollësishme e sasive të nevojshme dhe në rastet kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë duhet të aplikohet procedurë e hapur e prokurimit në harmoni me kërkesat ligjore të LPP-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Kompensim i punonjësve pa vijueshmëri në punë

Gjetja Rregullorja 05/2010 (neni 7) e shfuqizuar në gusht 2020 me hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve (neni 8), përcaktojnë se "Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për realizimin e marrëveshjes së ashtuquajtur "Mbrojta Civile". Përmes këtij vendimi, MTI ka të angazhuar 25 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integrimit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës nuk kanë punuar asnjëherë për MTI që nga viti 2016 kur edhe janë nënshkruar aktemrimet a tyre. Shpenzimi në total për pagat e këtyre të punësuarve për vitin 2020 ishte 122,738€, edhe pse për të njëjtit nuk ka dëshmi të vijimësisë në punë.

Mungesa e hapësirave të punës në komunat përkatëse ishte shkak kryesor për mos angazhimin e këtyre të punësuarve. Ministria kishte bërë përpjekje për adresimin e kësaj çështje gjatë vitit, duke dërguar shkresa tek ministritë përkatëse për marrje me qira ose sigurimin e hapësirave për këta të punësuar, mirëpo një gjë e tillë nuk ishte realizuar.

Ndikimi Pagesa e pagave pa vijueshmëri në punë shkakton dëmtim të buxhetit dhe njëherit ndikon në mosarritjen e objektivave të përcaktuara me marrëveshje.

Rekomandimi B1 Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të komunitetit serb, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunali në vitin 2020 ishte 2,280,215€, prej tyre ishin shpenzuar 1,847,514€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, blerje për rezerva shtetërore, shpenzime të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, dreka zyrtare dhe shpenzime tjera operative. Në këtë fushë kemi testuar 24 mostra për teste substanciale në vlerë 786,960€, dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë për procedura të prokurimit.

Çështja A2 - Realizim i shpenzimeve në mungesë të kontratës valide

Gjetja

Rregulla Financiare 01/2013 e MF-së për Shpenzim të Parasë Publike, neni 26, obligon të gjitha autoritetet publike, organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike, se asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e ligjit LMFPP.

Ministria e Administratës Publike me datë 29.03.2017 kishte lidhur kontratë Publike Kornizë me afat 36 muaj me Telekomin e Kosovës për Shërbimet -Telefonike mobile, internet,internet për GPRS, kabllo optike, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet e TV- kabllovik. Më pas, MTI kishte lidhur marrëveshje direkte me PTK për shfrytëzimin e kësaj kontrate publike Kornizë.Kjo marrëveshje kishte afat deri me 30.03.2020.

Gjatë rishikimit të pagesave për shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile kemi vërejtur që MTI kishte realizuar pagesat për këto shërbime edhe pas skadimit të afatit të kontratës me datë 31.03.2020. Pagesat totale të realizuara për periudhën prill - dhjetor ishin 17,473€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos lidhjes së kontratës së re nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

Ndikimi

Pranimet e shërbimeve pa mbështetje në dokumente ligjore, siç është kontrata, mund të shkaktojnë pranim të shërbimeve të pafavorshme dhe jo në përputhje me çmimet e tregut.

Rekomandimi A2

Ministrja në bashkëpunim me MPB-në të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 22,429,306€, pasurive jokapitale është 83,638€ si dhe e stoqeve 641€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 10,327,327€

Çështja A3 - Tjetërsim i pasurisë pa aprovim paraprak nga MF

Gjetja

Neni 9 paragrafi 2 i Rregullores së MF-së 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore përcakton se: "Për pasuritë kapitale të blera me fondet prej Grantit Qeveritar ose edhe me fonde donatorësh, para çdo tjetërsimi duhet të merret aprovimi edhe nga Ministria e Financave".

Krahasimet tona të bëra ndërmjet regjistrit të përgjithshëm të aseteve me regjistrin e automjeteve që janë në përdorim (regjistër i menaxhuar nga njësia për menaxhim të automjeteve), rezulton se numri i automjeteve nuk përputhet. Tetë (8) automjete të cilat në vitin 2014 ishin shitur përmes procesit të ankandit publik për 18,100€, ende figurojnë në regjistrin kontabël të aseteve. Përveç kësaj, shitja e këtyre automjeteve nuk ishte bërë me aprovim paraprak nga MF siç kërkohet me rregulloren nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Shitja e automjeteve ishte bërë në bazë të udhëzimit për ankand publik dhe nuk është dokumentuar kërkesa për aprovim nga MF për shitjen e tyre dhe as kërkesa e adresuar në këtë institucion për largimin e këtyre automjeteve nga regjistri i pasurive.

Ndikimi

Mos azhurnimi i regjistrit të aseteve ndikon në prezantim jo të saktë të numrit të aseteve të cilat janë në pronësi të MTI-së.

Rekomandimi A3

Ministrja duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të bëhet azhurnimi i regjistrit të aseteve duke larguar automjete të cilat nuk janë pronë e ministrisë që nga viti 2014.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurisë.

Gjetja

Nenit 6 i Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, parasheh se: "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuar në bazë të planit kontabël". Po ashtu, neni 22 thekson se: "Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit". Ky nen i rregullores përcakton edhe normat e zhvlerësimit për secilin kategori të pasurive.

Dy pagesa për blerje të pajisjeve për AMK (në vlerë 54,640€ dhe 26,050€) ishin regjistruar në SIMFK me vlerë totale të faturës. Në kuadër të këtyre faturave figuronin lloje të ndryshme të pajisjeve[6] dhe si rrjedhojë, zhvlerësimi i këtyre pasurive është aplikuar në vlerën totale si ''pajisje tjera"' dhe jo sipas normave të paracaktuara për çdo klasë të pasurive.

Kjo ka ndodhur për shkak të kuptuarit jo të drejt të kërkesave ligjore nga zyrtaret përgjegjës.

Ndikimi Regjistrimi i llojeve të ndryshme të pasurive vetëm me një klasë të llogarisë ndikon që përllogaritja e zhvlerësimit të jetë e pa saktë dhe jo në pajtim me kërkesat e rregullores.

Rekomandimi A4 Për tu llogaritur në mënyrë të drejtë dhe të saktë zhvlerësimi i pasurive, Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha blerjet të regjistrohen sipas kategorive të klasifikuara në bazë të rregullores përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mangësi në inventarizim të pasurive jo financiare

Gjetja Sipas rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë, neni 18 Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Ndërsa neni 19, përkufizon se përgjegjësi e komisionit të inventarizimit është inventarizimi i të gjithë pasurive jo financiare që janë në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore.

MTI kishte formuar komisionin për inventarizim të pasurive jo financiare dhe i njëjti me datë 24.12.2020 kishte dorëzuar raportin përkatës. Bazuar në këtë raport, komisioni kishte bërë inventarizimin vetëm për asetet e përfshira në e-pasuri duke mos përfshirë edhe asetet e regjistruara në SIMFK.

Të mos kuptuarit e drejtë të kërkesave të rregullores nga anëtaret e komisionit ishte bërë shkak i mangësive të identifikuara.

Ndikimi Mos harmonizimi i gjendjes faktike të aseteve me regjistrat kontabël pamundëson konfirmimin e ekzistencës reale të pasurisë dhe nuk mundëson prezantimin e gjendjes së plotë dhe të saktë të pasurisë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi C1 Ministrja duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive në çdo kohë. Më tutje, pas përfundimit të raportit të inventarizimit, të ndiqen proceset tjera përkatëse për harmonizim të regjistrave të pasurive para përgatitjes së PFV-ve me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit.

Çështja 1	**Korrigjimi i pasqyrave financiare vjetore**
Gjetja	Te Neni 14 'raporti i ekzekutimit të buxhetit'- Hyrja e parasë së gatshme – në shënimin 9, vlerat e buxhetit fillestar dhe final nuk ishin prezantuar në harmoni me informimin lidhur me projeksionet e të hyrave jo tatimore të dërguar me datë 25.01.2021 nga Ministria e Financave tek organizatat e nivelit qendror. Në këto kolona ishin prezantuar vlerat e buxhetit të përgjithshëm të organizatës dhe jo buxheti i planifikuar për të hyra. Ndërsa, te pjesa 'dalja e parasë së gatshme' buxheti fillestar nuk ishte prezantuar në harmoni me Ligjin e buxhetit 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2020.Sipas ligjit, buxheti fillestar ishte 88,215,312€, ndërsa në pasqyra figuron 12,250,000€. Pra, diferenca në mes vlerës së prezantuar në PFV me Ligjin e buxhetit është 75,965,312€. Gabimi i njëjtë ishte prezantuar edhe në kolonën e buxhetit fillestar te neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit / dalja e parasë së gatshme.
Veprimi i kërkuar	MTI duhet të ndërmerr masa konkrete që të eliminoj mangësitë e evidentuara në mënyrë që PFV të pasqyrojnë gjendjen e drejtë dhe të sinqertë. Pas prezentimit të vlerave të sakta të jepen detaje lidhur me ristrukturimet e kësaj ministrie të ndodhura gjatë viti.
Rezultati	Pas pranimit të shkresës tonë, MTI kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme duke korrigjuar dhe shpalosur të gjitha informacionet në PFV.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[7]	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**88,215,312**	**10,806,991**	**7,065,092**	**7,671,267**	**7,095,224**
Grante Qeveritare - Buxheti	58,237,688	6,104,110	5,840,642	6,950,444	7,046,220
Financimi përmes huamarrjes	11,174,386	1,069,643	525,186	167,748	49,004
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	18,803,238	2,933,238	0	59,700	0
Te hyrat nga AKP-ja	0	700,000	699,264	493,375	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 77,408,321€. Me ligjin e buxhetit për vitin 2020 në kodin organizativ të kësaj ministrie ishin të përfshira edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Agjencia e Punësimit, Agjencia e Inspektoratit të Punës, Ndërmarrësia dhe Divizioni për Investime Strategjike nga Ministria e Diasporës. Programi KIESA (Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë) i kësaj ministrie ishte bëre pjesë e Zyrës së Kryeministrit.

Më pas, për shkak të ndryshimeve politike është bërë ristrukturimi i qeverisë dhe MTI është kthyer prapë në strukturën e saj ngjashëm si në vitin paraprak.

Në vitin 2020, ministria ka shpenzuar 65% të buxhetit final ose 7,065,092€, ngjashëm me vitin 2019. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**88,215,312**	**10,806,991**	**7,065,092**	**7,671,267**	**7,095,224**
Pagat dhe mëditjet	5,079,622	1,858,746	1,858,722	1,663,711	1,591,815
Mallrat dhe shërbimet	7,828,407	2,235,175	1,805,730	2,058,638	1,684,470
Komunalitë	340,175	45,040	41,785	67,475	49,493
Subvencionet dhe transferet	37,438,870	1,600,560	1,279,224	1,313,803	1,943,046
Investimet Kapitale	37,528,238	5,067,470	2,079,631	2,567,640	1,826,400

Buxhetit final ishte zvogëluar krahas buxhetit fillestar për të gjitha kategoritë me rishikim të buxhetit për shkak të ristrukturimit të kësaj ministrie dhe vendimeve të ndryshme nga qeveria për ndarje, kursime dhe rregullime buxhetore si pasoj e situatës së krijuar me pandeminë COVID 19.

Pagesa të realizuara në vitin 2020 për shpenzime të Covid-19 ishin 18,586€. Prej tyre 10,080€ ishin realizuar nga kategoria e pagave dhe mëditjeve (projekti 00099) për Inspektorët e Tregut ndërsa pjesa tjetër 8,506€ nga kategoria e mallrave shërbimeve si furnizime për zyre.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020




Bazuar në diagramin e mësipërm, në vitin 2020 shpenzimet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve kishin rritje 14% krahasuar me vitin 2018 dhe 10% krahasuar me vitin 2019. Kjo rritje ishte rezultat i shtimit të një departamenti (Investimet Strategjike) në kuadër të strukturës administrative të kësaj organizate si dhe shtesave të stafit të Inspektoratit për menaxhim me pandeminë.

Për kategorinë mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale realizimi i shpenzimeve në vitin 2020 kishte rritje 6% krahasuar me vitin 2018 ndërsa krahasuar me vitin 2019 kishte rënie për 15%. Kjo për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19 duke pamundësuar realizimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit që në vitet e kaluara këto shpenzime ishin domethënëse për këtë kategori.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere ishin realizuar 52% me ulët se në vitin 2018 dhe 3% me ulët se vitin 2019.

Ndërsa, për investime kapitale shpenzimet në vitin 2020 ishin realizuar për 12% me lartë krahasuar me vitin 2018 ndërsa 23% më ulët krahasuar me vitin 2019. Realizimi më i ulët i shpenzimeve krahasuar me vitin 2019 ishte për shkak të shkurtimeve buxhetore dhe ndërprerjes së punimeve për një periudhë të caktuar për shkak të pandemisë.

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Në totalin e shpenzimeve të realizuara në vitin 2020, investimet kapitale përbëjnë 29.44% të shpenzimeve, pagat dhe mëditjet 26.31%, mallra dhe shërbimet 25.56%, subvencionet dhe transferet 18.11% ndërsa komunalitë përbëjnë vetëm, 0.59% të shpenzimeve totale.

Sipas informimit lidhur me projeksionet e të hyrave jo tatimore të nivelit qendror (2021-2023) të dorëzuar nga Ministria e Financave tek organizatat buxhetore , të hyrat e buxhetuara për MTI për vitin 2020 janë 2,348,231€, ndërsa, realizimi është 1,912,701€. Këto të hyra kanë të bëjnë me regjistrimin e pengut, pronësisë industriale, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale, licenca për importimin e naftës, licencat për importin e duhanit, të hyrat nga qiraja dhe të hyrat tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	**2,822,350**	**2,348,231**	**1,912,701**	**1,998,924**	**2,250,991**
Të hyrat jo tatimore	2,822,350	2,348,231	1,904,553	1,998,924	2,250,946
Të hyrat tjera	0	0	8,148		45

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ka rezultuar në 12 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna. Ministria gjithashtu ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (16 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar, një ishte adresuar pjesërisht, tre nuk aplikohen më, dhe dy nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën nr. 3.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Rek. B2-Ministri duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshi edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprak	Sipas informimit lidhur me projeksionet e të hyrave jo tatimore të nivelit qendror (2021-2023) të dorëzuar nga Ministria e Financave tek organizatat buxhetore, të hyrat e buxhetuara për MTI për vitin 2020 janë 2,348,231€, ndërsa, realizimi është 1,912,701€.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Pagat dhe mëditjet	Rek C1-Ministri duhet të vlerësoj situatën rreth kompensimit për profesionet deficitare duke siguruar se po zbatohen vendimet e qeverisë për të siguruar se personeli paguhet sipas dispozitave dhe akteve që lidhen me pozitat që mbajn	Me vendimin 02/Nr 15 të datës 22.01.2021, ZKA kishte bërë aplikimin e shtesës në pagë si personel deficitar.	I zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Rek B1-Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, Ministri rekomandohet që çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.	Përkundër faktit që Ministria kishte adresuar shkresa të vazhdueshme (dërguar MPB) për sigurimin e hapësirave të punës dhe gjithashtu kërkesën në MF për shtimin e buxhetit për marrje me qira të hapësirave në komunat veriore për akomodim të këtyre të punësuarve, kjo çështje nuk ishte zgjidhur as në vitin 2020.	Nuk është adresuar

4.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Rek C2-Ministri duhet të sigurohet se kërkesat rregullative janë mjaftueshëm të njohura tek zyrtarët e deleguar me mbajtjen e buxhetit duke ndikuar në ngritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve të cilën përfshihen në këto lloj shpenzime për të mos lejuar keqpërdorimet e mundshme të mjeteve të dhëna avanc. Të bëhet vlerësimi i dokumentacionit mbështetës dhe mjetet e paguara tepër të i kthehen buxhetit.	Në mostrat e testuara të avanseve për vitin 2020, nuk kishte tejkalime të limiteve të lejuara për shërbime të udhëtimeve zyrtare, mirëpo edhe në këtë vit kishte vonesa në mbyllje të tyre dhe në fund të vitit ishte vlera 7,732€ e avancave të pa mbyllura. Megjithatë, me datë 19.04.2021 MTI kishte mbyllur avancet e vitit 2020, ndërsa për pjesën tjetër prej 3,732€ janë ndjekur procedurat gjyqësore për kthimin e këtyre mjeteve.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Rek B3-Ministri duhet të siguroj që të plotësohen të gjitha vendet e lira të punës të aprovuara me buxhet dhe të siguroj se angazhimet e tilla iu përmbahen kërkesave ligjore	Gjatë vitit 2020 ministria kishte të angazhuar 32 persona me Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta, mirëpo deri në fund të vitit 2020 këtyre marrëveshjeve ju kishte skaduar afati dhe si të tilla nuk ishin vazhduar tutje nga Ministria.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Rek A 1-Ministri duhet të sigurohet se për procedurat e ndjekura janë lënë dëshmitë e zbatimit të kontrollit, si dhe në raste të tilla është bërë një vlerësim i drejtë i nevojave të ministrisë i dokumentuar dhe transparent.	Gjatë testimeve tona nuk kemi vërejtur raste të ngjashme.	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Rek A2-Ministri duhet të siguroj se do të rishikohen kontrollet si në mbajtjen e dosjeve duke ofruar siguri në mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave, ashtu edhe në hartimin e dekumenteve kontraktuese.	Gjatë testimeve tona nuk kemi vërejtur mangësi në dokumentimin e procesit të prokurimit.	I zbatuar


8.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Rek A3-Ministri duhet të sigurohet se po bëhen dakordimet e duhura para pranimit të çfarëdo shërbimi, si dhe që ato po dokumentohen me dëshmi të arsyeshme rreth shërbimeve të pranuara.	Gjatë testimeve për vitin 2020 nuk kemi identifikuar mangësi të kësaj natyre.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Rek A4-Ministri duhet të sigurojë që MTI duhet të krijoj të gjitha parakushtet ndaj OE që hartimi i projekteve dhe punët tjera të kontraktuara të kryhen sipas kushteve të kontratës.	Në mostrat e testuara në vitin 2020, nuk kemi identifikuar raste të vonesave në punët e kontraktuara.	I zbatuar
10.	Pasuritë	Rek B4-Ministri duhet të qartësoj kërkesat rregullative, të nxjerrë udhëzim të brendshëm lidhur me inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe të trajnoj stafin relevant, në mënyrë që kërkesat e rregulloreve për pasuritë të zbatohen me konsistencë.	Me datë 20.10.2020 MTI kishte hartuar udhëzimin e brendshëm të pasurive. Ndërsa, edhe pse ishte përfunduar procesi i inventarizimit, i njëjti nuk ishte përfunduar për të gjitha pasuritë që ka ministria por vetëm për pasuritë e regjistruara në e - pasuri.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Rek.B5-Ministri duhet të siguroj se do të shqyrtohen të gjithë mekanizmat ligjor në inkasimin e të arkëtueshmeve të vonuara, duke kalkuluar edhe interesin e përcaktuar nga tregu bankar dhe me kontratë. Në rastet e mosrespektimit të kushteve të kontratës nga operatores të shqyrtoj mundësinë e shkëputjes.	Edhe në vitin 2020, Llogaritë e Arkëtueshme kishin trend rritës krahasuar me vitin paraprak.Këtë çështje e kemi trajtuar në letër menaxhment.	Nuk është adresuar

12.	Obligimet e papaguara	Rek B6-Ministri i tregtisë duhet të siguroj se do të vendos nën kontroll obligimet, duke siguruar mos hyrë në obligime pa fonde të planifikuara me buxhet, si dhe të kryej të gjitha obligimet detyrimet brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Në PFV- të e vitit 2020 obligimet e papaguara ishin prezantuar në vlerë 79,782€. Nga kjo vlerë 64,075€ ishin pagesa të refuzuara nga MF për shkak të kufizimit në bilancin bankar dhe të njëjtat ishin paguar në vitin 2021. Si rrjedhojë, obligimet e papaguara ishin për 165,670 me pak se vitin e kaluar.	Nuk është i aplikueshëm më

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Ministri duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshi edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprak
2.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore.
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të komunitetit serb, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore.
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja në bashkëpunim me MPB-në të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve..
5.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të sigurohet se specifikat teknike janë hartuar në harmoni me projektet ekzekutive dhe aprovimet e ndryshimeve duhet të behën vetëm për rastet e lejuara me ligj. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja për punë shtesë të bëhet një analizë e hollësishme e sasive të nevojshme dhe në rastet kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë duhet të aplikohet procedurë e hapur e prokurimit në harmoni me kërkesat ligjore të LPP-së.
6.	Pasuritë	Ministri duhet të qartësoj kërkesat rregullative, të nxjerrë udhëzim të brendshëm lidhur me inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe të trajnoj stafin relevant, në mënyrë që kërkesat e rregulloreve për pasuritë të zbatohen me konsistencë.
7.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të bëhet azhurnimi i regjistrit të aseteve duke larguar automjete të cilat nuk janë pronë e ministrisë që nga viti 2014.
8.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive në çdo kohë. Më tutje, duhet të sigurojë pas përfundimit të raportit të inventarizimit, të ndiqen proceset tjera përkatëse për harmonizim të regjistrave të pasurive para përgatitjes së PFV-ve me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive me të cilat disponon organizata.

9.	Pasuritë	Për tu llogaritur në mënyrë të drejtë dhe të saktë zhvlerësimi i pasurive, Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha blerjet të regjistrohen sipas kategorive të klasifikuara në bazë të rregullores përkatëse.
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të siguroj se pas aplikimit të gjithë mekanizmve tjër ligjor në inkasimin e të arkëtueshmeve të vonuara, në rastet e mosrespektimit të kushteve të kontratës nga operatoret të shqyrtoj mundësinë e shkëputjes së kontratave.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Arvita Zyferi, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Florim Beqiri, Udhëheqës i Auditimit




Shpresa Zenelaj, Udhëheqëse e ekipit




Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Mjellma Dibra, Anëtare e ekipit



Laureta Matoshi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë/Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Tergovine/Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për vitin 2020 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Rozeta Hajdari

Ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Data: 18 qershor 2021 Prishtinë,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[8] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.[9] . Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] LPP (neni 35 pika 2.4) dhe RRUOP (neni 52 pika 3) specifikon se AK mund të përdor procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për dhënien e çfarëdo kontrate publike për zbatimin ose ekzekutimin e shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë as në konceptimin fillestar të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën përkatëse të punëve që është përmbyllur më parë, por të cilat, përmes rrethanave të paparashikuara, janë bërë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve ose punëve të përshkruara në projektin ose kontratën e tillë. Më tutje, me kusht që, ky nen 35.2.4(i) të mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime ose punë shtesë që vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës fillestare.

[6] Automjet, Peshore elektrrike, Kompjuter, Printer etj

[7] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[8] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[9] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.